



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 163, Datë 05.06.2026

MBI

**SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR. 199, DATË 15.08.2025 “MBI DHËNIEN E
AUTORIZIMIT NGA ERE PËR VENDOSJEN E KUOTAVE TË SHOQËRISË
RENEW” SH.P.K. SI MJET PËR GARANTIMIN E PËRMBUSHJES SË DETYRIMIT
NDAJ “PROCREDIT BANK” SH.A.**

Në mbështetje të, nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 05.06.2026, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 1616/1 prot., datë 02.06.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi shfuqizimin e vendimit nr. 199, datë 15.08.2025 “Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të shoqërisë “RENEW” sh.p.k. si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj “PROCREDIT BANK” sh.a.” ,

Konstatohet se:

- Shoqëria “RENEW” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike me vendimin e bordit të ERE-s nr. 68, datë 08.04.2025, i ndryshuar.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 199, datë 15.08.2025, ka miratuar dhënien e autorizimit për vendosjen e kuotave të shoqërisë, si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj Procredit Bank sh.a.
- Shoqëria ka plotësuar sa kërkuar në pikën 3 të vendimit nr. 199/2025, si e tillë kjo pikë është shfuqizuar me vendimin e bordit të ERE-s me nr. 264, datë 21.10.2025.
- Në kuadër të kushtit referuar pikës 4 të vendimit, me shkresën e fundit të përcjellë me nr. 1616 prot., datë 18.05.2026, shoqëria sqaron se ka shlyer totalin e financimit të marrë, ndaj ka depozituar deklaratën noteriale të bankës, datë 12.05.2026, me anë të të cilës është dhënë pëlqimi për heqjen e pengut mbi kuotat e shoqërisë dhe zhbllokimin e tyre nga cdo detyrim që rrjedh nga kontratat e nënshkruara. Gjithashtu shoqëria ka depozituar ekstraktin historik të QKB-së, nga shqyrtimi i të cilit rezulton/evidentohet se në datë 14.05.2026 është pasqyruar

deklarata noteriale për heqjen e pengut mbi kuotat e shoqërisë të vendosura mbi bazën e kontratës nr. 740 rep., nr. 437 kol., datë 19.03.2025.

- Për gjithë sa më sipër, përsa kërkuar nga vetë subjekti, e në rrethanat që arsyeja kryesore për të cilën është dhënë ky autorizim ka rënë, si dhe në mbështetje të nenit 113, të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vlerësojmë se jemi në rrethanat e shfuqizimit të vendimit nr. 199, datë 15.08.2025 “Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të shoqërisë “RENEW” sh.p.k. si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj “Procredit Bank” sha”.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të shfuqizojë vendimin nr. 199, datë 15.08.2025 “Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të shoqërisë “RENEW” sh.p.k. si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj “Procredit Bank” sh.a.”.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë “RENEW” sh.p.k., “Procredit Bank” sh.a. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI